

URDHËR
Nr.209, datë 19.12.2007

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR REALIZIMIN E
STUDIMIT TË THELLUAR TË PAKETËS FISKALE TË PUSHTETIT VENDOR**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, për realizimin e studimit të thelluar të paketës fiskale të pushtetit vendor.

2. Grupi i punës të kryesohet nga këshilltari i Kryeministrit për çështjet e financave publike, z.Petra Milo dhe, në përbërje të ketë:

- z.Skënder Uku specialist në Ministrinë e Financave;
- znj. Arjana Dyrmishi specialiste në Ministrinë e Financave.

Në mbledhjet e grupit të punës, në cilësinë e ekspertit, të përfshihen sipas propozimeve të ardhura nga shoqata e kryetarëve të bashkive edhe këta përfaqësues:

- znj.Albana Dhimitri nënkryetare e bashkisë Tiranë;
- z.Juli Cani specialist, nga shoqata e kryetarëve të bashkive;
- znj.Belinda Ikonomi specialiste, bashkia Tiranë.

3. Grupi i punës të shqyrtojë praktikën e ndjekur deri tani, në kuadër të autonomisë financiare të pushtetit vendor, për decentralizimin e taksave vendore, si dhe të studiojë mundësitë e mëtejshme të këtij decentralizimi fiskal, në bazë të përvojës së vendeve të Europës Juglindore dhe Qendrore, që janë integruar apo synojnë të integrohen në Bashkimin Europian.

4. Studimi i plotë i paketës fiskale t'i paraqitet Kryeministrit dhe shoqatave të të zgjedhurve vendorë brenda 2 muajve nga data e ngritjes së grupit ndërinstitucional të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha